



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64, nenin 70 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 6, paragrafi 1.4 dhe nenin 8 paragrafi 1 të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2024, Emërimi, Përbërja dhe Funksonimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, si dhe kërkesës, të datës 12.12.2024, të subjektit politik GISPO, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 18.12.2024, nxjerr këtë:

## V E N D I M

### **Për emërimin dhe zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Komunën e Deçan**

- I. Z. Liridon Tetaj, emërohet anëtar i KKZ-së në komunën e Deçanit nga subjekti politik IRDK, duke e zëvendësuar z. Qëndrim Jollaj, nga i njëjti subjekt politik, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 Shkurt 2025.
- II. Mandati i anëtarit të emëruar të KKZ-së, do të fillojë nga data e emërimit sipas këtij vendimi dhe do të përfundojë pesëmbëdhjetë (15) ditë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të afatit ose zgjatet me vendim të KQZ-së.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### **Arsyetim**

Me vendimin e KQZ-së Nr.01/289-2024, të datës 16.09.2024, z. Qëndrim Jollaj, nga subjekti politik IRDK, është emëruar anëtar i KKZ-së, ndërsa me kërkesën e subjektit politik në fjalë, të datës 12.12.2024, ka kërkuar zëvendësimin për arsyeje personale nga pozita e anëtarit të KKZ-së. Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 18.12.2024

**Kreshnik RADONIQI**

**Kryesues i KQZ**





**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64, nenin 70 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 6, paragrafi 1.4 dhe nenin 8 paragrafi 1 të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2024, Emërimi, Përbërja dhe Funksonimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, si dhe kërkesës, të datës 12.12.2024, të subjektit politik IRDK, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 18.12.2024, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për emërimin dhe zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Komunën e Shtimes**

- I. Z. Driton Velija, emërohet anëtar i KKZ-së në komunën e Shtimes nga subjekti politik GISPO, duke e zëvendësuar znj. Arjeta Maliqi, nga i njëjti subjekt politik, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 Shkurt 2025.
- II. Mandati i anëtarit të emëruar të KKZ-së, do të fillojë nga data e emërimit sipas këtij vendimi dhe do të përfundojë pesëmbëdhjetë (15) ditë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të afatit ose zgjatet me vendim të KQZ-së.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

- V. Me vendimin e KQZ-së Nr.01/289-2024, të datës 16.09.2024, znj. Arjeta Maliqi, nga subjekti politik IRDK, është emëruar anëtare e KKZ-së, ndërsa me kërkesën e subjektit politik në fjalë, të datës 12.12.2024, ka kërkuar zëvendësimin për arsyeje se është kandidate për deputete në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 Shkurt 2025. Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 18.12.2024





**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
**Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova**

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 23 të Rregullores së Brendshme Nr. 02/2024, Për Pranimin e Personelit të Përkohshëm në KQZ, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 18.12.2024, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**Për Miratimin e Kërkesës së Divizionit për Buxhet dhe Financa, për Angazhimin e Personelit të Përkohshëm për Procesin Zgjedhor**

- I. Miratohet Kërkesa e Divizionit për Buxhet dhe Financa, për angazhimin e dy zyrtarëve të përkohshëm, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025.
- II. Kërkesa si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 18.12.2024

**Kreshnik RADONIQI**

**Kryesues i KQZ**

